

SHTOJCE NR. 1

**“Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit,
“Procedurë e hapur” me objekt “Blerje materiale të ndryshme për pastrim” ndarë në
2(dy) lote, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku jo të gjitha kushtet janë të
përcaktuara.**

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me disa operatorë ekonomik ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite me objekt **“Blerje materiale të ndryshme për pastrim” ndarë në 2(dy) lote** dhe me fond total të marrëveshjes kuadër në vlerën prej 169,728,038 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, hartoi këtë shtojcë për ndryshime të dokumenteve të tenderit, si më poshtë:

Në dokumentet e tenderit, Shtojca 9, Loti I. “Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Hiqet gërma (b) – “*Certifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj*” në nënpikën e 2 (dytë) të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”.

Në dokumentet e tenderit, Shtojca 9, Loti II. “Blerje materiale të ndryshme për pastrim”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Hiqet gërma (b) – “*Certifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj*” në nënpikën e 2 (dytë) të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”.

Në zbatim të pikës 2/1 të nenit 42 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me disa operatorë ekonomik ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite me objekt “Blerje materiale të ndryshme për pastrim” ndarë në 2(dy) lote, afati kohor për dorëzimin e ofertave, shtyhet për në datën 08.04.2019 ora 11:00.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.